



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 30 / 2025

Datë: 27 / 01 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), si dhe në përputhje me neni 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjin nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34, 18 Nëntor 2022), duke u bazuar në nenin 22 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe në bazë të kërkesës me nr.prot.08-24, të datës 08.01.2025, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Leonard Krasniqi ndërmjetësues i licencuar në Republikën e Kosovës i pezullohet Licenca e Ndërmjetësuesit me nr. 16/2011.
2. Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Leonard Krasniqi, me datë 08.01.2025 ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesë për pezullimin e Licencës për Ndërmjetësues pasi që i njëjti është dekretuar në pozitën e Prokurorit të Republikës së Kosovës me nr. të dekretit 225/2024.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës së tij, duke u bazuar në të lartcekurat dhe legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albulena Haxhiu

Ministër e Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi i'u dërgohet:

- *Z. Leonard Krasniqi;*
- *Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës;*
- *Gjykatës Themelore në Pejë;*
- *Prokurorisë Themelore në Pejë;*
- *Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*